



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kuvendit të Komunës
12 Nr. 360-8839 dt. 27.06.2013

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të kapitullit të III, pika 10(10.1, 10.2, 10.3 dhe 10.4) dhe nenit 11 të Programit dhe Udhëzuesit për Banim Social, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit dhe Vendimit 06Nr.360-5232 të datës 11.04.2013 të Komisionit verifikues, raportit të këtij komisioni të datës 12.04.2013 dhe informata sipas raportit nga DSHMS e datës 28.05.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me dt. 21.06.2013 miraton këtë:

VENDIM

- I. LEJOHET vazhdimi i kontratave mbi dhënien në shfrytëzim të banesave sociale në Bllokun e II-të (dytë) në Drenasin 3, të gjithë përfituesve të këtyre banesave sipas Programit dhe Udhëzuesit për Banimin Social edhe për 2(dy) vjet.
- II. Gjendja ekonomike e familjeve dhe numri i banorve në Banimin Social, Blloku II-të në Drenasin 3, sipas Aktvendimit të Përfituesve të Banimit Social është përafërsisht në nivelin e kohës kur kanë përfituar të drejtën e Banimit Social.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës duke nënshkruar kontratat për shfrytëzimin e banesave sociale me përfituesit me Drejtoratin për Shëndetësi e Mirëqenje Sociale-Sektori i MS.
- IV. Me këtë Vendim do të njoftohen: Drejtoratët e Komunës së Drenasit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë dhe një mbetët për evidence.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj

